




		REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-4540/14
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. I faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	02.12.2014
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 26.11.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-3932-14 për z. *Shabi Idrizi – Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik* për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3932-14, për Zyrtarin e lartë, z. Shabi Idrizi – Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj-dega Kaçanik dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Idrizi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Idrizi është deklaruar se keto ndryshime i ka bërë, por për këtë nuk i është dhënë asnjëherë konfirmimi nga ARBK, të cilin do ta kërkoj tash dhe do ta sjell për të vërtetuar kështu se nuk ka konflikt interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, z. Idrizi, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellë një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-4339/14) bashkë me "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se biznesi privat, A.Sh.J."Jetoni" tashmë është shuar në mënyrë vullnetare.

Tani, z.Idrizi, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Ferizajit – Dega Kaçanik.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
★ Hasan Preteni

